



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale të OST/OT-së

Përgjigjet ndaj Komenteve (OST/OT)

Periudha e Dytë Rregullative (2018-2022)

DEKLARATË

Ky Raport është përgatitur nga ZRRE-ja me qëllim të informimit të palëve të interesuara të sektorit të energjisë. Ky raport nuk paraqet ndonjë vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë.

24 Shtator 2018



Përmbajtja

1	Hyrje	1
2	Shpenzimet operative	2
2.1.1	Komentet e KOSTT-it	2
2.1.2	Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së	3
2.2	Lejimi i humbjeve	4
2.2.1	Komentet e KOSTT-it	4
2.2.2	Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së	4
2.3	Shërbimet ndihmëse	4
2.3.1	Komentet e KOSTT-it	4
2.3.2	Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së	4
2.4	Shpenzimet kapitale.....	5
2.4.1	Komentet e KOSTT-it	5
2.4.2	Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së	6
2.5	Fondi për BRE	6
2.6	Përmbledhje e MAR të KOSTT.....	7



1 Hyrje

Pas vlerësimit fillestar të Aplikacioneve lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për të licencuarin e Operatorit të Sistemit, të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT, KOSTT), i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi t'i paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.

Me qëllim të vlerësimit sa më të drejtë të MAR për OST/OT, përfaqësuesit e ZRRE-së dhe KOSTT kanë pasur disa takime për të sqaruar kalkulimet në vlerësimin fillestar. Nga ky proces interaktiv i komunikimit ndërmjet ZRRE-së dhe KOSTT ka rezultuar në disa plotësime e të cilat nuk kanë pasur ndikim substancial në ndryshimin e vlerësimit fillestar.

Ky dokument paraqet përgjigjet në komentet e bëra nga palët e interesuara, dhe propozimin e ZRRE-së lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT-së.

Lidhur me vlerësimin fillestar të të Hyrave të Lejuara Maksimale të OST/OT-së, ZRRE nuk ka pranuar ndonjë koment nga ndonjë palë tjetër përveç komenteve të OST/OT-së të cilat janë të përshkruara në vazhdim.



2 Shpenzimet operative

2.1.1 Komentet e KOSTT-it

Shpenzimet operative bazë

KOSTT-i ka dhënë një numër argumentesh si përgjigje ndaj propozimeve të ZRRE-së:

- Shpenzimet operative (“opex”) të realizuara në Periudhën e Parë Rregullative (PRr1) kanë tejkaluar në masë të madhe nivelet e lejuara për arsye të cilat janë jashtë kontrollit të KOSTT-it, me një opex të realizuar në total prej 36.7 milion € gjatë kësaj periudhe, krahasuar me një total të lejuar prej 34.2 milion €. Duke pasur parasysh këtë diferencë ekzistuese, është e paarsyeshme që të pritët që KOSTT të zvogëlojë opex-in e realizuar në nivelin e lejuar në vitin 2017, të cilin ZRRE-ja propozon që të përdorë si pikënisje për lejimet për PRr2. KOSTT pretendon se një qasje e tillë do ta vendoste në vështirësi të mëdha financiare operatorin.
- ZRRE-ja ka nënvlerësuar opex-in e kërkuar nga KOSTT për shkak të një gabimi në llogaritje. Diferenca e vërtetë midis kërkesës së KOSTT-it dhe lejimit të propozuar nga ZRRE-ja është më e madhe se ajo e specifikuar në Raportin Konsultativ të ZRRE-së.
- Trajtimi i disa zërave të shpenzimeve tjera operative si fond i veçantë për anëtarësime në organizata ndërkombëtare nuk është vlerësuar korrekt, pasi që pjesa më e madhe e këtyre kostove parashihet të jetë kosto për trajnime dhe zhvillim të stafit dhe pjesëmarrje në grupet punuese që ndërlidhet me proceset e anëtarësimeve në ato organizata, kurse një pjesë e vogël për pagesa fikse të anëtarësimeve. Andaj, kjo vijë buxhetore nuk do të duhej të ndahej nga shpenzimet tjera operative e as të trajtohet si pagesë e anëtarësimeve sepse nuk është e tillë.
- KOSTT-i ka detyrime të ndryshme ligjore dhe të tjera të cilat nuk mund të reduktohen ose të eliminohen dhe për të cilat duhet të sigurohen mjete në opex siç janë sigurimi i ndërtesave dhe sigurimi i aseteve, shërbimet komunale dhe ato përcjellëse të numrit të madh të objekteve të KOSTT të cilat bartin një kosto të lartë.
- Në kategorinë e pagave duhet të përfshihen edhe pagat për operatorët e NS Vallaq, meqë nënstacioni Vallaq është pronë e KOSTT-it..

Duke pasur parasysh këto rrethana, KOSTT-i deklaron se kërkesa e vetë origjinale për opex duhet të miratohet në tërësi (që përfaqëson një total të opex-it prej 50.9 milion € për PRr2 krahasuar me lejimin e propozuar nga ZRRE-ja prej 35.7 milion €).

Ndryshimet vjetore të kostos

KOSTT-i gjithashtu thekson që nuk është e pranueshme që të vendoset caku i faktorit të efikasiteti prej 1.5% në vit kur opex-i i lejuar tashme është shumë më poshtë se nivelet e realizuara, madje edhe përpara aplikimit të këtij faktori të efikasitetit.



2.1.2 Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së

Shpenzimet operative bazë

ZRRE-ja konsideron se qasja e saj në vendosjen e opex-it bazë të lejuar është tërësisht në përputhje me rregullat dhe parimet rregulatore, ku të licencuarit (në këtë rast, KOSTT) i lejohen të hyra të arsyeshme për mbulimin e kostove dhe është në gjendje të mbajë një pjesë nga përfitimet e reduktimit të kostove të realizuara nën këtë nivel (sipas faktorit ndarës të kursimeve) dhe rreziqeve të tejkalimit të tyre. Nëse i licencuari lejohet që të bartë të gjitha ndryshimet në kosto atëherë nxitja për kursime dhe efikasitet nuk do të kishte asnjë efekt dhe kështu konsumatorët do të vazhdonin të ngarkoheshin me kosto të paarsyeshme dhe në rritje të vazhdueshme.

ZRRE-ja gjithashtu konsideron se KOSTT-i nuk ka arritur të arsyetoj mjaftueshëm opex-in shumë më të lartë të kërkuar për PRR2 në lidhje me nivelet e realizuara dhe të lejuara për PRR1. Sipas komenteve të KOSTT-it, opex-i i realizuar në vitin 2017 ishte 6.94 milion € dhe në vitin 2016 ishte 7.38 milion €. Opex-i i lejuar në dy vitet e njëjta ka qenë 6.45 milion € dhe respektivisht 6.64 milion €. Megjithatë, për vitin e parë të PRR2, KOSTT-i është duke propozuar një opex të lejuar prej 9.70 milion €, që paraqet një rritje rreth 40% në raport me realizimin në PRR1 dhe rreth 47% në nivelet e lejuara në PRR1. Arsyet e rritjes nga KOSTT-i nuk arsyetojnë një ndryshim kaq të madh.

Prandaj, ZRRE-ja konsideron se propozimi i saj për OPEX të PRR2 për KOSTT-in, lejon të hyra të mjaftueshme për të operuar, duke konsideruar edhe ngritjen e kapaciteteve profesionale për përmbushjen e obligimeve që do të dalin me anëtarësimet në organizata relevante ndërkombëtare. Kështu pjesa prej 0.3 mil € e cila ishte e dedikuar gjatë vlerësimit fillestar të MAR për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, pas argumenteve të KOSTT-it, ky fond do të reduktohet në 0.2 milion € dhe do të përdoret për përgatitjen e stafit për anëtarësimet në organizata relevante ndërkombëtare. Gjithsesi KOSTT duhet të ketë në konsideratë arritjen e caceve të përcaktuara nga ZRRE, ku përfshihen niveli i caktuar i humbjeve dhe efikasiteti në shpenzimet operative për PRR2.

Në lidhje me kostot shtesë për operimin e NS Vallaq, KOSTT pas kërkesës së ZRRE, ka dërguar një vlerësim prej 76 mijë € si të nevojshme për të mbuluar shpenzimet e stafit për 7 punëtorë, kosto këto, të cilat do të jenë të ndryshueshme varësisht nga aspekti kontraktual. ZRRE propozon që vlera shtesë prej 76 mijë € për vit, të përfshihet në OPEX të KOSTT dhe në varësi të ndryshimeve eventuale pas hyrjes në obligime kontraktuale, të jetë e azhurnueshme gjatë përshtatjeve të rregullta vjetore.

Ndryshimet vjetore të kostos

ZRRE-ja konsideron se nuk ka nevojë që të përshtatet faktori i supozuar i efikasitetit. Shqetësimet e ngritura nga KOSTT-i lidhur me diferencën në mes të OPEX-it bazë të realizuar dhe atij të lejuar janë diskutuar më lartë. ZRRE-ja ka kuptuar se është po kjo diferencë që po i nxitë komentet e KOSTT-it për faktorin e efikasitetit.



2.2 Lejimi i humbjeve

2.2.1 Komentet e KOSTT-it

KOSTT në komentet për MAR për PRR2 ka komentuar edhe njëherë çështjen e humbjeve të lejuara nga ZRRE. KOSTT ka ripërsëritur edhe njëherë që KOSTT në vazhdimësi ka paraqitur fakte dhe analiza se niveli aktual i humbjeve është niveli më i ulët i mundshëm dhe trendi i tyre si pasojë i zgjerimit të rrjetit do të merr kahje tjetër dhe do të fillon të rritet në të ardhmen. Prandaj, KOSTT dëshiron të vejë në pah se caku i përcaktuar nga ZRRE për humbjet e transmetimit prej 1.78%, paraqet një rrezik real dhe do të jetë vështirë i arritshëm.

2.2.2 Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së

Çështja e nivelit të humbjeve të lejuara në Transmetim ka qenë subjekt i një procesi të veçantë të shqyrtimit, gjatë të cilit janë përfshirë analiza teknike dhe financiare, të cilat i janë nënshtruar një konsultimi publik me të gjitha palët e interesit. Si rrjedhojë e gjithë procesit Bordi i ZRRE, ka marrë vendim për nivelin e humbjeve të lejuara të transmetimit.

ZRRE dëshiron të theksoj edhe njëherë që KOSTT është lejuar të mbajë nivelin mesatar të humbjeve të realizuara gjatë PRR1, prej 1.78% edhe në PRR2, nivel ky i cili është konsideruar i arsyeshëm dhe i arritshëm nga ana e KOSTT. Një aspekt i cili mund të ketë ndikim në rritjen nivelin të humbjeve në Transmetim, mund të jetë transiti i energjisë, mirëpo ashtu siç është theksuar në shqyrtimin e vlerave hyrëse, ZRRE do të marrë në konsideratë këtë aspekt pas definimit të KOSTT si zonë rregulluese dhe kur trajtimi i transitit të energjisë të definohen qartë.

2.3 Shërbimet ndihmëse

2.3.1 Komentet e KOSTT-it

KOSTT-i, në komentet e saj argumenton se duhet të lejohet që për së paku një pjesë të kostove të mundshme të blerjes së rezervave terciare të mbulohen nga MAR i propozuar për PRR2, në mënyrë që të mos rrezikohet aplikimi i saj për anëtarësim në ENTSO-E. Të pasurit e burimeve të mjaftueshme financiare për të blerë këto rezerva kërkohet nga të gjithë anëtarët e ENTSO-E. Prandaj, KOSTT propozon se një dispozitë fillestare për 50% të kostove të vlerësuara të blerjes duhet të përfshihet në MAR të saj për PRR2 me ndonjë diferencë midis kësaj dhe kostove të realizuara të menaxhuara përmes përshtatjeve vjetore.

2.3.2 Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së

Pozicioni i ZRRE-së mbetet i pandryshuar nga Raporti Konsultativ. Në këtë raport, ZRRE-ja ka paraqitur qëndrimin e saj se, duke marrë parasysh paqartësitë rreth kohës se kur KOSTT-i mund të anëtarësohet në ENTSO-E, nuk ka nevojë të menjëhershme që të sigurohet mbulimi për këto kosto. Në momentin që KOSTT do të jetë pjesë e ENTSO-E, lejimi i kostove për rezervë terciare do të bëhet gjatë procesit të përshtatjeve vjetore.



2.4 Shpenzimet kapitale

2.4.1 Komentet e KOSTT-it

KOSTT ka komentuar largimin e disa projekteve nga ana e ZRRE nga programi i investimeve të propozuar nga KOSTT, nën arsyetimin se disa nuk paraqesin net-benefit pozitiv, ndërsa disa të tjera nuk kanë të paraqitura alternativa tjera të mundshme për investime.

Arsyeshmëria e KOSTT në lidhje me projektet në fjalë është si në vijim:

Projekti me ID 010: Instalimi i TR2 (40 MVA) në NS 110/10(20) Klinë

- Ky projekt është i domosdoshëm për plotësimin e kriterit N-1, respektivisht mbajtjen e sigurisë së furnizimit të konsumatorëve në përputhje me kërkesat ligjore dhe si i tillë duhet të përfshihet në programin e investimeve kapitale për PRR2.

Projekti me ID 012: Riparimi i linjës 110 kV Prizren 1—Prizren 3 dhe Projekti ID 013: Ndërtimi i linjës së re 110 kV Prizren 1—Prizren 2

- Linja e dytë e re në Prizren është më se e domosdoshme për plotësim të kriterit N-1, kjo është sqaruar në arsyetimin e detajuar të dërguar më parë në ZRRE, gjithashtu siguria e operimit të nënstacioneve për shkak të vjetërsisë së aseteve është faktori tjetër i cili argumenton se ky projektet duhet të mbetet në programin e investimeve kapitale.

Projekti me ID 017: Riparimi i NS Klina dhe NS Burimi

- Siguria e operimit të nënstacioneve për shkak të vjetërsisë së aseteve është prioritet i këtij projekti andaj nuk duhet larguar nga programi.

Projekti me ID 020: Instalimi i paneleve solare në nënstacione

- Ky është investim me grant prandaj është me interes për KOSTT dhe konsumatorët që ky investim të realizohet, sepse kostoja është zero dhe kemi eficiencë. Gjithashtu, panelet solare do të duhej të përkrahen nga ZRRE, pasi hyn në kuadër të përkrahjes së BRE-ve dhe atë me ndikim pozitiv të konsumatori vendor, duke reduktuar konsumin e KOSTT.

Projekti me ID 022: Riparimi i pajisjeve të TL 110 kV në NS Vallaq

- Përveç sigurisë së sistemit që duhet të jetë prioritet për gjithë akterët e sistemit energjetik në vend edhe arsyet politike do të duhej të merren parasysh dhe ky projekt duhet të mbetet pjesë e programit.

KOSTT ka argumentuar nevojën për zhvillimin e këtyre projekteve ashtu si edhe të gjitha projekteve tjera në planin investiv duke u bazuar në plotësimin e kërkesave të ligjeve dhe rregullave në fuqi, kriterit N-1, nevojave të konsumatorëve dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës, nevojave të zhvillimit të rrjetit dhe përmirësimit në ato pjesë ku është i vjetërsuar etj

Për më tepër KOSTT argumenton se Faza VI-VII e paket projekteve të financuara nga KfW, pjesë e të cilave janë edhe projektet ID 010, ID 012 dhe ID 017, negociimi i kësaj marrëveshje ka përfunduar dhe ka marrë miratimin e Qeverisë së Kosovës dhe ri-negociimi i kësaj marrëveshje bart rreziqe të



shumta financiare dhe zhvillimore për sistemit e Transmetimit dhe konsumatorët e energjisë elektrike në Kosovë.

2.4.2 Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së

ZRRE dëshiron të theksoj se qëllimi parësor i investimeve në sektorin e energjisë është siguria e furnizimit, shërbime kualitative dhe të përballueshme për konsumatorët e energjisë elektrike në Kosovë.

Fillimisht duhet të sqarohet që gjatë fazës së parë të konsultimit publik, ZRRE ka larguar të gjitha projektet nga plani investiv për të cilat nuk është ofruar arsyeshmëri e mjaftueshme në bazë të Rregullës për Vlerësimin e Projekteve Kapitale në Rrjetin e Transmetimit dhe Shpërndarjes në Sektorin e Energjisë Elektrike. Si rrjedhojë disa projekte janë “larguar”, me kërkesën për ofrimin e të dhënave dhe analizave shtesë, ku do të dëshmohej që investimet janë të domosdoshme dhe mënyra e investimeve e propozuar nga KOSTT, paraqet mënyrën më të arsyeshme për investime.

Pas pranimit të analizave shtesë dhe argumenteve tjera të ofruara nga KOSTT, dëshmohet që këto investime do të kontribuojnë në përmirësimin e sigurisë së furnizimit, plotësimin e kriterit N-1, do të ruajnë vazhdimësinë e zhvillimit të Sistemit të Transmetimit dhe do të japin kontribut të rëndësishëm në krijimin e parakushteve për zhvillim ekonomik dhe nxitje të investimeve në përgjithësi. Gjithashtu nga analizat e dërguara të KOSTT shihet se alternativat e propozuara për projektet në fjalë paraqesin opsionet më të pranueshme në raport me alternativat tjera të mundshme.

Prandaj ZRRE propozon që edhe projektet: *Projekti me ID 010: Instalimi i TR2 (40 MVA) në NS 110/10(20) Klinë; Projekti me ID 012: Riparimi i linjës 110 kV Prizren 1—Prizren 3 dhe Projekti ID 013: Ndërtimi i linjës së re 110 kV Prizren 1—Prizren 2; Projekti me ID 017: Riparimi i NS Klina dhe NS Burimi*; të përfshihen në planin investiv dhe do të jenë pjesë e Bazës së Aseteve të Rregulluara (BAR), me datën e komisionimit, ndërsa projektet të cilat do të jenë donacion si: *Projekti me ID 020: Instalimi i paneleve solare në nënstacione dhe Projekti me ID 022: Riparimi i pajisjeve të TL 110 kV në NS Vallaq* do të jenë pjesë e planit investiv, mirëpo nuk do të jenë pjesë e BAR pas komisionimit, sepse ky është parim rregullator që për donacionet nuk lejohet që të ngarkohen konsumatorët.

ZRRE dëshiron të sqaroj që edhe përkundër që KOSTT nuk kishte ndonjë koment në lidhje me jetëgjatësinë e mbetur për asetet e PRR1, megjithatë ZRRE ka bërë një korrigjim për të reflektuar vlerën e skat të jetëgjatësisë së mbetur i cili rezulton në vlera minimale pas përshtatjes në propozimin për MAR-in përfundimtar.

2.5 Fondi për BRE

ZRRE ka përshtatur kostot e fondit të BRE-ve për të pasqyruar dallimin ndërmjet kostove të lejuara dhe atyre të realizuara në vitin 2017. Kostot e vlerësuara të këtij fondi për vitin 2018 janë rreth 6.2mil€, ndërsa kostot që lejohen të përfshihen në MAR janë 2.8mil€, pëkatësisht ky dallim duhet të mbulohet nga të hyrat e tejkaluara në vitin 2017.



2.6 Përmbledhje e MAR të KOSTT

Pas vlerësimit të të gjitha të dhënave në dispozicion dhe ato të paraqitura nga palët e përfshira në proces dhe palët e interesit, si dhe pas komenteve të pranuar nga KOSTT gjatë konsultimit publik, duke marrë në konsideratë edhe vendimet e Bordit të ZRRE-së për vlerat hyrëse për PRR2, vlerësimi dhe propozimi përfundimtar i ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit, Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) për periudhën e dytë rregulative 2018-2022 është si më poshtë:

Tabela: MAR i propozuar për PRR2, sipas entitetit

€000s	PRR2				
	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)					
Baza Opex	5,586	5,508	5,430	5,353	5,278
Zhvlerësimi	8,330	8,960	9,532	9,972	10,288
Kthimi i Lejuar	8,034	8,868	9,605	10,302	10,621
Të hyrat jo-tarifore	-454	-454	-454	-454	-454
Përshtatjet e vitit 2017	-103	-103	-103	-103	-103
Përshtatjet Capex- PRR1	-1,036	-1,036	-1,036	-1,036	-1,036
Të hyrat e mbetura nga KEK (5 vite)	-3,329	-3,329	-3,329	-3,329	-3,329
Totali	17,027	18,413	19,644	20,705	21,264
Operatori i Sistemit (OS)					
Baza Opex	1,573	1,550	1,528	1,506	1,485
Kosto e Humbjeve	4,577	4,154	4,115	4,110	4,102
Kostot e Shërbimeve Ndihmëse	2,593	2,663	2,733	2,733	2,803
Zhvlerësimi	1,178	1,307	1,310	1,301	1,317
Kthimi i Lejuar	478	477	432	367	295
Përshtatjet e vitit 2017	-27	-27	-27	-27	-27
PRR1 Përshtatjet Capex	- 85	- 85	-85	-85	-85
Totali	10,287	10,038	10,006	9,905	9,890
Operatori i Tregut (OT)					
Baza Opex	264	238	235	231	228
Kostot e Shërbimeve Ndihmëse	0	-	-	-	-
Zhvlerësimi	23	46	67	88	124
Kthimi i Lejuar	10	19	25	29	38
Të hyrat jo-tarifore	-	-	-	-	-
Fondi i burimeve të ripërtitshme ¹	2,873	n/a	n/a	n/a	n/a
Përshtatjet e vitit 2017	-6.9	-6.9	-6.9	-6.9	-6.9
PRR1 Përshtatjet Capex	-0.3	-0.3	-0.3	-0.3	-0.3
Totali	3,164	296	320	342	382
KOSTT total	30,477	28,747	29,970	30,951	31,536

¹ Këto kosto do të përshtaten në baza vjetore dhe janë neutral ndaj tarifave të rrjetit të OST dhe OSSh-së